

# Dokumentacioni për DËMET SHËNDETËSORE

Për cdo kërkesë për dëmshpërblim  
duhet të plotësohen dokumentat  
vijuese:



# DOKUMENTE TË PËRGJITHSHME:

## Njoftimi/Kërkesa

e palës së dëmtuar për dëmshpërblim e regjistruar pranë shoqërisë së sigurimit (postë/email/telefon/kërkesë e drejtëpërdrejtë)

Pala e dëmtuar duhet të plotësojë të gjitha hapësirat e njoftim kërkesës për dëmshpërblim, sipas formatit të miratuar nga shoqëria e sigurimit. Gjithashtu të shpjegojë me hollësi rrethanat e ngjarjes.

## Konfirmimi i mbulimit në sigurim nga shoqëria e sigurimit, të mjetit shkaktar të dëmit;

Konfirmimi i mbulimit në sigurim të mjetit shkaktar të dëmit, bëhet nga shoqëria e trajtimit të dëmeve "VIG Services" dhe shoqërohet me policën e sigurimit të mjetit shkaktar të dëmit.

## Formulari i Vërtetimit miqësor të ngjarjes;

Formulari i Vërtetimit miqësor të ngjarjes (sipas formatit të miratuar nga Autoriteti), duhet të paraqitet nga pala e dëmtuar. Formulari duhet të plotësohet me korrektësi dhe besnikëri nga pjesëmarrësit në aksident dhe të jetë i nënshkruar nga këto pjesëmarrës.

## Proces verbali i konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore për ngjarjen;

Proces verbali i konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore është dokumenti i cili përcakton përgjegjësinë e drejtuesit të mjetit shkaktar të dëmit. Proces verbali i konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore konsiderohet i rregullt kur ai është lëshuar në përputhje me dispozitat e Kodit Rrugor.

Vendimi i Prokurorisë për ngjarjen, kur në aksident rezultojnë vdekje dhe/ose plagosje të rënda;

Vendimi i formës së prerë i gjykatës (për përgjegjësitë në aksident, kur njëri nga drejtuesit e mjeteve motorike të përfshirë në aksident rezulton me vdekje ose plagosje të rëndë), ose vendimi i prokurorisë kur çështja është pushuar.

## DOKUMENTE SPECIFIKE:

Certifikata familjare dhe Letër Njoftimi / ID;

Certifikata familjare e personit të dëmtuar, në rastin e paaftësisë së përhershme (e pjesëshme ose totale) dhe të përkohshme, duhet të jetë sipas formatit zyrtar, e nënshkruar dhe e vulosur nga organi kompetent.

Vërtetimi i të ardhurave neto personale për tre vitet e fundit;

Vërtetimi i të ardhurave neto personale për tre vitet e fundit (duke filluar nga data e aksidentit), i detajuar për çdo muaj duhet të lëshohet nga punëdhënësi dhe të konfirmohet nga organet e sigurimeve shoqërore ose tatim taksa.

Për dëmet shëndetësore me pasojë vdekje, përveç atyre të parashikuara me lart do të përfshihen edhe dokumentet e mëposhtme:

- a. Skeda e vdekjes;
- b. Certifikata e vdekjes;
- c. Vendimi i Gjykatës për përcaktimin e trashëgimtareve të të ndjerit.

Për dëme shëndetësore me paaftësi të përhershme përveç atyre të parashikuara më lart do të përfshihen edhe dokumentet e mëposhtme:

- a. Raporti i paaftësisë së përhershme për punë i cili duhet të shpreh në përqindje masën e paaftësisë, duke u bazuar në tabelën "Shkalla e humbjes së paaftësisë së përhershme në punë" e përcaktuar nga KMCAP.
- b. Radiografi / Skaner / Rezonancë magnetike epikrizë / anamezë / fletë-shtrimi dhe fletë-dalja nga spitali dhe çdo dokument tjetër që ndihmon në vlerësimin e dëmit të lëshuar nga organet kompetente.

Për dëme shëndetësore me paaftësi të përkohshme përveç atyre të parashikuara më lart, do të përfshihet edhe:

- a. Raporti i paaftësisë së përkohshme, i cili duhet të jetë sipas Modelarit Tip të lëshuar nga organi kompetent.
- b. Radiografi / Skaner / Rezonancë magnetike / epikrizë / anamezë / fletë-shtrimi dhe fletë-dalja nga spitali si edhe çdo dokument tjetër që ndihmon në vlerësimin e dëmit të lëshuar nga organet kompetente.

 Rruga Dritan Hoxha,  
pranë Pallatit të Sporteve, Larak ë,

 +355 4 220 3330  +355 67 60 48703 

 demet@vig.al